

# Informacion për prindërit

Si prindër ju jeni partnerët më të rëndësishëm, kur bëhet fjalë për zgjedhjen e parë të profesionit të fëmijës tuaj. Për një kalim të suksesshëm nga shkolla në mësimin e një profesioni ose në shkolla më të larta, të rinjtë kanë nevojë për përkrahjen tuaj.

## Zgjedhja e profesionit në shkollë

Përgatitja për zgjedhjen e profesionit në shkollë fillon në klasën e 7. Mësimi ka si qëllim, të drejtojë nxënësit dhe nxënëset në temat më të qenësishme të zgjedhjes së profesionit. Të rinjtë merren me shqyrtimin e interesave dhe aftësive të tyre dhe njihen me fusha profesionale të ndryshme.

## Ju si prindër luani një rol të rëndësishëm në zgjedhjen e profesionit


- Ndhimoheni vajzën/djalin tuaj, që të angazhohen hap pas hapi me zgjedhjen e profesionit dhe që të zhvillojnë idetë e para mbi profesionet.
- Tregojini djalit/vajzës tuaj mbi zgjedhjen që keni bërë ju për profesionin dhe flisni mbi jetën e përditshme në profesionin tuaj. Kështu i mundësoni fëmijës tuaj një vështrim në botën e punës.
- Shfrytëzoni rastet e përshtatshme, për të folur mbi interesat dhe aftësitë e fëmijës tuaj. Këto mundet ndoshta të japin një farë orientimi për një drejtim profesional të përshtatshëm.
- Flisni me vajzën/djalin tuaj mbi temat që trajtohen në orën e mësimin të zgjedhjes së profesionit dhe shikojini së bashku fletët e punës.
- Merrni me seriozitet idetë e fëmijës tuaj për profesionin. Pas dëshirës për një profesion shpesh qëndron një nevojë, që ka të bëjë me djalin ose me vajzën tuaj.
- Tregoni interesim dhe diskutoni hapat që mund të merren më tej, si p.sh. pjesëmarrjen në një aktivitet informativ ose një provë në vendet e mësimin, me qëllimin për ta analizuar dëshirën për një profesion.
- Të rinjtë janë të varur nga impulse dhe nxitje të vazhdueshme nga ana e prindërve të tyre. Njëkohësisht inkurajoheni djalin/vajzën tuaj, që të kryejë sa më shumë gjëra vetë.

## Është mirë të dihet,

- që zgjedhja e parë e profesionit nuk është diçka përfundimtare, por është një fillim. Ajo është një hap i parë, mbi të cilën mund të ndërtohet më vonë. Sistemi arsimor zviceran ofron mundësi të shumta.
- që nuk ka profesione të mira ose të këqija. Një profesion i mirë është ai, që i përshtatet një personi, sepse ai i përgjigjet interesave dhe aftësive të tij.
- që të rinjtë janë më tepër aktiv në zgjedhjen e profesionit, në qoftë se ata edhe në jetën e përditshme e kanë mundësinë, të ushtrjnë situata të marrjes së vendimeve dhe të marrjes përsipër të përgjegjësisë.
- që zgjedhja e profesionit për të rehat dhe të rinjtë është njëloj e rëndësishme. Vendimi për profesionin nuk do të duhej të ishte i varur nga gjinia.

## Plani i ecursisë për zgjedhjen e profesionit

Plani i ecursisë për zgjedhjen e profesionit jep një vështrim mbi të gjitha aktivitetet, të cilat i ndihmojnë të rinjtë në procesin e zgjedhjes së profesionit. Ai shtrihet gjatë gjithë shkollës sekondare dhe tregon, se çfarë është planifikuar dhe në cilin moment.



## Shfrytëzoni mundësitë e shumëllojshme të informacionit

- Shoqërojeni djalin/vajzën tuaj në BIZ. Në një këshillim të shkurtër me një këshilluese ose këshillues të profesionit ju keni mundësinë të sqaroheni për pyetjet tuaja. Atje gjithashtu mund të huazohen broshura.  
Orari i hapjes së BIZ:  
[www.biz.lu.ch](http://www.biz.lu.ch)
- Informacion rreth zgjedhjes së karrierës:  
[www.beruf.lu.ch/berufswahl](http://www.beruf.lu.ch/berufswahl)
- Në [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch) > Berufe do të gjeni përshkrime për profesionet, filma mbi profesionet dhe informacione të tjera ndihmuese për zgjedhjen e profesionit.
- Përshkrime të shkurtra mbi mundësitë e arsimimit shkollor do të gjeni nën [www.beruf.lu.ch/studium](http://www.beruf.lu.ch/studium) > Gymnasien und Fachmittelschulen.
- Për profesionet e ndryshme dhe shkollat e mëtejshme zhvillohen aktivitete informuese të vazhdueshme. Ato mund të kërkohen nën: [www.beruf.lu.ch/sprung](http://www.beruf.lu.ch/sprung).
- Motivoheni fëmijën tuaj, të kryejë vizita prove për mësimin. Këshilla se si veprohet dhe lista të firmave që ofrojnë mësim profesioni ju do të gjeni nën [www.beruf.lu.ch/berufswahl](http://www.beruf.lu.ch/berufswahl) > Schnupperlehre & Lehrstellensuche.
- Përkraheni vajzën/djalin tuaj në kërkimin e vendit të mësimit të profesionit. Të gjitha çfarë vlejnjë për tu ditur në lidhje me këtë ju do t'i gjeni nën [www.beruf.lu.ch/berufswahl](http://www.beruf.lu.ch/berufswahl) > Schnupperlehre & Lehrstellensuche.
- Vendet e lira të mësimit janë të paraqitura nën [www.berufsberatung.ch/lena](http://www.berufsberatung.ch/lena).
- Një vështrim të përgjithshëm mbi zgjedhjet e ndërmjetme pas arsimit të detyrueshëm mund të nxirrni nga faqja [www.beruf.lu.ch/berufswahl](http://www.beruf.lu.ch/berufswahl) > Zwischenlösungen.
- Bursat  
[www.stipendien.lu.ch](http://www.stipendien.lu.ch)